

UDK: 327.56::351.88
364.2::316.37

Review article

SIGURIA E PIKË KALIMEVE KUFITARE NGA AKSIDENTET DHE INCIDENTET E NDRYSHME

MSc Samir Krasniqi*

Abstrakt:

Është e njohur dhe dëshmuar se siguria është problem qëndror për çdo shoqëri të konsoliduar dhe politike gjithëpërfshirëse të asaj shoqërie, ku janë të kyçur të gjithë mekanizmat shtetëror, pavarësisht se çfarë forme të rregullimit shoqëror ka ajo shoqëri. Përveç sigurisë njerëzore-individuele, në kuadrin e ndarjes sipas llojeve, mund të flasim edhe për sigurinë juridike, shoqërore dhe po ashtu botërisht është e njohur dhe dokumentuar se siguria kufitare dhe sidomos siguria e Pikë Kalimeve Kufitare (PKK) nga aksidentet dhe incidentet e ndryshme, është një shtyllë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

Gjatë zhvillimit historik të shoqërisë është e pamundur të gjenden instanca të formësimit dhe të strukturimit të bashkësive që kanë ekzistuar në periudha më të gjata kohore, por që nuk kanë pasur nevojë për ndonjë formë të organizimit mbrojtës ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve që ju kanë kanosur. Në këtë rrugë të ndërtimit të shoqërisë bashkëkohore, juridike dhe qytetare, anëtarët e bashkësisë kanë synuar dhe kanë shprehur nevojën për siguri, gjegjësisht për eliminimin e të gjitha formave të rrezikut dhe kërcënimeve, që mund të vënë në pikëpyetje ekzistencën e asaj shoqërie (integritetin fizik, sigurinë përgjithshme, sigurinë individuale, pasurinë, etj.), që mund paraqiten në forma të ndryshme, si nga jashtë kufijve dhe po ashtu nga brenda.

Siguria njerëzore përqendrohet në krijimin e një mjedisi ku të gjithë njerëzit ndjehen të sigurt dhe kjo i kontribuon sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Koncepti i sigurisë, përmbajtja e tij dhe funksioni shoqëror, mund të kuptohen vetëm në qoftë se ky fenomen vështrohet në mënyre interdisiplinare, si për shembull në shkencat e sigurisë, mbrojtjes, kriminalistikës, etj.

Fjalët kyçe: siguria, siguria njerëzore, pikë kalimi kufitar, aksident, incident.

* Dogana e Kosovës, e-mail: samirk42@yahoo.com.

HYRJE

Qëllimi im i përgjithshëm është trajtimi i njëres ndër çështjet më të vështirë dhe të ndjeshme të vendit " siguria e Pikave të Kalimit Kufitar (PKK) nga aksidentet dhe incidentet e ndryshme". Jam plotësisht i vetëdijshëm për faktin se kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe një temë shumë e ndjeshme për t'u shtjelluar. Siç e dimë të gjithë, historia na tregon se kufijtë janë "plagët e historisë" dhe në ndërkohë shtyllë kritike e sigurisë kombëtare.

Siguria e Pikë Kalimeve Kufitare (PKK) nga aksidentet dhe incidentet e ndryshme

Botërisht është e njohur dhe dokumentuar se siguria kufitare dhe sidomos siguria e Pikë Kalimeve Kufitare (PKK) nga aksidentet dhe incidentet e ndryshme, është një shtyllë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

Bazuar në përvojat e shteteve me sisteme të avancuara të sigurisë dhe praktikave të ndryshme vendore, krijimi dhe avancimi i kushteve dhe mekanizmave të sigurisë, konsiderohet si një faktor dhe element i rëndësishëm që i mban njerëzit e rrezikshëm dhe materialet e rrezikshme jashtë territorit të një vendi, para se terroristët mund të marrin veprime dhe të jenë në gjendje apo pozicion për të sulmuar. Me fjalë të tjera, ajo është parandaluese në kuptimin e vet dhe në këtë mënyrë paraqet një qasje optimale për politikën e sigurisë kombëtare. Konsideroj se siguria e kufirit nuk duhet të shihet kryesisht vetëm si një siguri dhe mbrojtje e perimetrit të vendit. Kjo nuk nënkupton vetëm krijimin e një hendeku të thellë rreth kufijve kombëtar, por përkundrazi, kërkon bashkërendim të aktiviteteve si brenda vendit, atë ndërkufitar dhe rajonal. Kjo është një përpjekje që shfrytëzon faktin që njerëzit dhe mallrat janë relativisht lehtë të vëzhguar kur ata arrijnë në pikat e kontrollit.

Siguria kufitare paraqet diçka të afërt me sigurinë apo mbrojtjen e drejtpërdrejtë fizike të kufijve, më së shumti, ka të bëjë me përpjekjet e patrullës kufitare dhe doganore përgjatë perimetrit të gjatë të vendit, si dhe disa aktivitete të agjencive tjera shtetërore. Por roli i sigurisë kufitare si tërësi dhe koncept i ri është edhe më kritik.¹

Përvoja dhe praktikat e deritanishme dëshmojnë faktin se kryerja e drejtë e aktiviteteve rreth sigurisë kufitare mund të ofrojnë përfitime shtesë edhe përtej sferës së sigurisë kombëtare. Shtetet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, kanë ngritur sisteme kufitare të digjitalizuara dhe të kompjuterizuara, të cilat lejojnë lëvizjen më të besueshme dhe të shpejtë të njerëzve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit. Sipas shfrytëzimit dhe kapaciteteve që kanë, ato gjithashtu ofrojnë njohuri më të mirë ku janë apo gjenden kamionët dhe mallrat edhe kur janë në transit. Kjo mund të nënkuptohet përveç të tjerash edhe si një aftësi më e madhe për të parandaluar ose

¹ Robert S. Leiken, *Bearers of Global Jihad? Immigration and National Security after 9/11* (Washington, D.C.: Nixon Center, March 2004).

për t'u përgjigjur ndaj aktiviteteve tjera të rrezikshme për njerëzit dhe veçanërisht ekologjisë dhe ambientit, ku rrjedhimisht ky duhet të jetë qëllimi i sigurisë më të lartë kufitare.

Lista e rreziqeve të mundshme të cilat mund të bëhen aksidente dhe incidente në pikat e kufitare

Siç u potencua edhe më lart, kufijtë janë "plagë të historisë", andaj duke e ditur këtë fakt, bazuar në praktikat moderne dhe përvojat rajonale dhe vendore, mund të theksoj se bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve ndër-kufitare ndihmon për të reduktuar të metat e këtyre kufijve dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës për njerëzit në të dy anët e kufirit. Ky bashkëpunim dhe bashkërendim duhet të përfshijë të gjitha sferat e jetës (kulturore, sociale, politike, ekonomike, sportive, infrastrukturore, etj). Siguria kufitare dhe sidomos siguria e PKK-ve nga incidentet dhe aksidentet, mban larg rrezikun, njerëzit dhe materialet e rrezikshme, para se ata të mund apo edhe të jenë në gjendje të sulmojnë.

Qeveria e secilit vend duhet të krijoj dhe avancoj kapacitetet dhe mekanizmat funksional dhe njëkohësisht të jetë në gjendje të sigurojë mekanizmin e *paralajmërimit të hershëm* të një sulmi të mundshëm nëpërmjet Sistemit për Paralajmërim Emergjent (SPE), që duhet të vendoset nëpër PKK ose në afërsi të zonave që mund të vënë në rrezik një numër të madh të popullatës, në mënyrë që të ndihmojnë në parandalimin dhe zbulimin e ndonjë sulmi kimik ose biologjik, si dhe për paralajmërim të emergjencave dhe situatave tjera.

Pikat e shkruara më poshtë janë rreziqet kryesore të mundshme që mund të rrezikojnë PKK-të dhe zonën përreth:

Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM)

Një armë e shkatërrimit në masë është një armë që mund të vras një numër të madh të njerëzve (dhe format e tjera të jetës) dhe / ose të shkaktojë dëme të mëdha në strukturat e bëra nga njeriu (p.sh. ndërtesa), struktura natyrore (p.sh. malet), ose biosferën në përgjithësi.² Qëllimi dhe aplikimi i termit ka evoluar dhe është diskutuar shpesh duke i dhënë rëndësi më shumë në aspektin politik se sa teknik. E shpikur në lidhje me bombardimet ajrore me eksplozivë kimike, ajo ka ardhur në shfrytëzim dhe për një shkallë të gjerë armësh e teknologji tjera, të tilla si kimike, biologjike, radiologjike apo bërthamore. Kjo dallon termin nga ato më teknike të tilla si kimike, biologjike, radiologjike dhe të armëve bërthamore (CBRN). Kodi i SHBA-së dhe kodet e tjera kombëtare japin disa përkufizime të ndryshme të armëve të shkatërrimit në masë, të aplikueshme në kontekste të ndryshme. Për qëllime të

² http://www.fbi.gov/about-us/investigate/terrorism/wmd/wmd_faqs dhe www.nato.int/topics_5032.

përgjithshme të mbrojtjes kombëtare, Kodi i SHBA përcakton një armë të shkatërrimit në masë, si:

"Çdo armë ose pajisje që ka për qëllim, ose ka aftësinë, për të shkaktuar vdekjen ose lëndimet e rënda trupor të një numri të konsiderueshëm të njerëzve përmes lirimimit, shpërndarjes, ose ndikimit të:

- Kimikateve toksike ose helmuese ose prekursorëve të tyre;
- Një virusi (sëmundje) ose
- Rrezatimit apo radioaktivitetit. "

Për qëllime të parandalimit të përhapjes së armëve, Kodi i SHBA-së përcakton armët e shkatërrimit në masë, si: "Armë kimike, biologjike dhe bërthamore dhe materialet kimike, biologjike dhe bërthamore të përdorura në prodhimin e armëve të tilla."³

Për qëllimet e kodit penal të SHBA-së lidhur me terrorizmin, armët e shkatërrimit në masë janë përkufizuar si:⁴

- "çdo pajisje shkatërruese siç është përkufizuar në nenin 921 të këtij titulli;
- çdo armë që është projektuar ose për qëllim të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor me anë të lëshimit, shpërndarjes, ose ndikimit të kimikateve toksike ose helmuese, ose prekursorëve të tyre;
- çdo armë që përfshin një agjent biologjik, toksina, ose vektor ; ose
- çdo armë që është projektuar për lirimimin e rrezatimit apo radioaktivitetit në një nivel të rrezikshëm për jetën e njeriut. "

Nevoja për masa mbrojtëse kundër Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM) ishte rritur në nivel më të lartë si pasojë e 11 Shtator-it 2001 në SHBA. Aftësia për t'u mbrojtur kundër përdorimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM), në mbarë botën është duke u njohur si një nga çështjet kryesore dhe më të mëdha të sigurisë me të cilat përballen kombet dhe vendet e ndryshme, rajoni ynë në përgjithësi dhe po ashtu edhe Kosova në veçanti.

Armët kimike dhe biologjike

Armët kimike dhe biologjike janë disa nga kimikatet dhe sëmundjet më të rrezikshme dhe të njohura për njeriun. Armët kimike dhe biologjike janë substanca organike dhe inorganike kimike që janë të dëmshme për njerëzit. Ka disa lloje të ndryshme të agjentëve kimikë. Të gjitha veprojnë në mënyra të ndryshme, por janë të njëjta në një aspekt, kur janë të një niveli të lartë, të gjitha vrasin njerëzit.⁵

³ <https://www.law.cornell.edu/uscode/text/18/2332a>

⁴ <https://www.law.cornell.edu/uscode/text/18/921>

⁵ <http://www.armscontrol.org/factsheets/cbwprolif>

<http://www.state.gov/t/avc/rls/rpt/2013/index.htm>

Situata e tanishme në aspekt global na tregon se këto armë janë në ballë të kërcënimeve terroriste dhe ushtarake për sigurinë tonë. Lufta kimike dhe biologjike, konsiderohet " si një mundësi e njeriut të varfër," për shkak të mundësisë, lehtësisë dhe çmimit të lirë të prodhimit dhe kasaphanës dhe terrorit që ata mund të shkaktojnë pa dallim. Lind pyetje se:

Si do të dini se një sulm biologjik ose kimik ka ndodhur?

Praktikat kanë treguar se sulmet biologjike dhe kimike shfaqin shumë karakteristika të dallueshme, siç janë:

- Kafshë / Zogj / peshk të ngordhur: kafshë të shumta të ngordhura në të njëjtën zonë.
- Skuqje: Shumë individë përjetojnë skuqje të pashpjegueshme, djegësim sikur kur të pickon bleta, dhe / ose puçrra me ujë.
- Dëme masive: Shumë persona shfaqin probleme serioze dhe të pashpjegueshme shëndetësore duke filluar nga çorientimi dhe vështirësitë në frymëmarrje, shtrëngime dhe vdekje.
- Aroma të pashpjegueshme: Era mund të shkoj nga shije e frutave me lule të idhet / të era e rëndë /erë e hudhrës, pjeshkës / bajame e hidhur apo aromë sikur e barit të sapo kositur. (dmth aroma e barit në një zonë urbane).
- Sëmundja shoqërohet në një sipërfaqe të mbyllur gjeografike
- Mungesa e jetës së insekteve: mungojnë aktivitetet normale të insekteve/ kontrolloni terrenin / brigjet / ujin për insekte të ngordhura. Gjithashtu kontrolloni për kafshë të ngordhura / Zogj / peshk.
- Pika të pazakonshme të lëngshme: Shumë sipërfaqet shfaqin pika të lëngshme.

Përveç këtyre shenjave, mund të përdoren pajisje për zbulim të një sulmi kimik, por zakonisht jo aq lehtë një sulm biologjik. Për të zbuluar një sulm biologjik, ju duhet të shikoni për shenja të shpërndarjes, të tilla si re të pazakonta, spërkatje, etj.

Helmet kimike, plumbi dhe metalet tjera të rënda

Helmi kimik, plumbi dhe metalet tjera të rënda, janë shqetësim i madh për shëndetin publik. Përafërsisht 95% e të gjithë helmimeve aksidentale apo të qëllimshme janë për shkak të kimikateve. Gati 90% e këtyre rasteve ndodhin në shtëpi, por derisa njerëzit kanë qëllime të ndryshme ata po ashtu mund ta përdorin për qëllime të ndryshme. Bazuar në praktikat dhe rastet e zbuluara, plumbi është gjetur shpesh në ngjyrë, pesticide, qeramikë, ngjyrë të artistëve dhe produkteve të përdorura për hobi dhe zejtari. Gjithashtu të dëmshme janë edhe metalet e tjera të rënda, të tilla si merkuri dhe kadmiumi.. Shumë sëmundje kronike, degenerative

kanë qenë të lidhura me ndotjen e mjedisit ose helmimin. Lista mund të përfshijë kancerin, humbjen e kujtesës, alergji, ndjeshmëri kimike të shumëfishtë, sindromi i lodhjes kronike, infertilitet të rriturit, çrregullime në të mësuar dhe sjellje, anomalit në zhvillim dhe defekte në lindje të fëmijëve.

Forma tjetër e helmimit kimik është **Anthrax-i**. Ekspertët kanë llogaritur se një armë me antraks me synim për të sulmuar një qytet të madh mund të vret të paktën 123.000 njerëz, edhe në qoftë se çdo viktimë ka marrë trajtim. Hulmuesit amerikanë kanë përdorur një model kompjuterik për të parashikuar shkatërrimin që do të rezultonte nga hedhja e një bombe të antraksit ose raketë në një qytet të madhësisë së New York-ut. Shifrat janë të bazuara në atë që do të ndodhte nëse një bombë që përmban 1 kilogram të antraksit hidhet në një qytet prej 10 milion banorësh. Ekspertët e kësaj fushe kanë deklaruar se antraksi nuk është një armë e shkatërrimit në masë, por një armë e histerisë masive.⁶ Këto lloj materiale mund të transportohet lehtë nëpërmjet kufirit dhe veçanërisht përmes Pikave të Kalimit Kufitar. PKK-të dhe personeli që janë drejtpërsëdrejti të përfshirë në kontrollin e këtyre zonave janë në rrezik më të lartë për helmime aksidentale (akute).

Drogat

Drogat janë problemi më i madh për të gjithë popujt dhe shoqëritë moderne. Kjo është me të vërtetë problem i madh për agjencitë e kufirit, në mënyrë që të mbrojnë qytetarët e tyre nga sëmundja moderne e quajtur **drogë**. Me droga (për të përmendur disa) nënkuptohet: qetësuesit, opiumi, kokaina, heroina, marihuana, amfetamina dhe LSD dhe pluhuri **engjell**, të cilat janë më të këqijat. Ka mijëra emra tregtarë dhe zhargon të rrugëve për këto droga. Alkooli gjithashtu është klasifikuar si një lloj droge. Përgjithësisht, është çdo substancë që kur absorbohet në trupin e një organizmi të gjallë, ndryshon funksionet normale trupore.⁷

Trafikimi i drogës është i lidhur shpesh me krime të tjera të rënda të tilla si kontrabanda me njerëz, prostitucioni, krimi i organizuar dhe falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit. Ajo është përmendur shpesh si një mjet për të financuar aktivitetet më të dhunshme dhe shkatërruese të organizatave kriminale dhe terroriste, për shkak të përfitimeve të mëdha dhe parave që rrjedhin për një periudhë të shkurtë kohore dhe investime minimale. Format e tjera të drogës që mund të shkaktojnë incidente në kufi nganjëherë janë **ilaçet**.

Ilaçet janë një nga shkaqet më të zakonshme të (vetëvrasjeve) helmimeve aksidentale dhe të qëllimshme. Ilaçet që përdoren më së shpeshti janë aspirina,

⁶Steinman, David and R. Michael Wisner (1996). *Living Healthy in a Toxic World: Simple Steps to Protect You and Your Family from Everyday Chemicals, Poisons, and Pollution*. New York, NY: The Berkley Publishing Group,

⁷ www.fda.gov/Drugs/

Acetaminophen, qetësuesit, çdo drogë psikoaktive, ku një pacient është më i prirur për veprime impulsive, vetëvrasje (p.sh., ilaçet kundër depresionit), pilula hekur, vitamina/ minerale shtojca që përmbajnë hekur, dhe ilaçet e zemrës, të tilla si digoxin dhe quinidine. Ky lloj materiali mund të transportohet lehtë përmes kufirit dhe veçanërisht përmes PKK-ve.⁸

Nevoja për masa mbrojtëse kundër drogës ishte e dukshme dhe nevojshme si pasojë e disa konfiskimeve të drogës të kryera nga autoritetet kufitare. Aftësia për t'u mbrojtur kundër përdorimit të drogës është duke u njohur si një nga çështjet më të rëndësishme të sigurisë me të cilat përballen shtetet, rajoni dhe po ashtu Kosova.

Bioterrorizmi

Bioterrorizmi nënkupton përdorimin e qëllimshëm të mikro-organizmave ose përbërësve helmues që mund të prodhohen nga disa mikrobe dhe që luajnë rolin e armës. Bioterrorizmi mund të jetë një program qeveritar i zhvillimit të armëve të sanksionuara dhe që mund të jetë i mirë-organizuar, ose mund të përfshijë një grup të vogël njerëzish të përkushtuar për kauzën e tyre të veçantë. Bioterrorizmi i referohet lirim të qëllimshëm të agjentëve biologjik apo toksinave me qëllim të dëmtimit apo vrasjes së njerëzve, kafshëve ose bimëve me qëllim për të frikësuar apo të detyruar një qeveri, ose popullsinë civile për arritjen e objektivave të mëtejshme politike ose sociale.⁹ Në të kaluarën, armët e përdorura nga shtetet e ndryshme lehtë njiheshin dhe kishte mundësi të mbroheshin prej tyre. Për shembull, mekanizmat mbikëqyrës lejojnë që koka e raketave të zbulohet dhe ndërmerren masa mbrojtëse apo kundër-strategji lidhur me nisjen e raketave. Megjithatë, mikro-organizmat për shkak të madhësisë së tyre të vogël mund lehtë të fshihen (maskohen) nga zbulimi i tyre. Një shishe e vogël e antraksit, e cila lehtë mund të fshehët në një xhep-mund të lirohet në sistemin e ventilimit të një ndërtese. Aftësia për t'u mbrojtur kundër përdorimit të armëve biologjike, është duke u njohur si një nga çështjet më të rëndësishme të sigurisë me të cilat përballen shtetet.¹⁰ Forma lidhur me strategjitë e gatishmërisë dhe reagimit janë subjekt i një debati të gjerë publik në tërë globin. Ky lloj materiali mund të transportohet lehtë nëpërmjet kufirit dhe veçanërisht PKK-ve andaj është e nevojshme preventiva dhe bashkëpunimi ndër-kufitar, rajonal dhe më gjerë.

⁸ www.drugrehab.co.uk/illegal-drugs.htm


⁹ <http://www.dhs.gov/>

¹⁰ <http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/tp/bioterrorism.htm>

Bacillus Anthracis



Shembull i një pakoje të dyshimtë



Rrezatimi

Rrezatimi është energjia në proces të shpërndarjes (transmetimit), e cila mund të marrë forma të tilla si drita ose grimca të vogla shumë të vogla për t'u parë. Drita e dukshme, drita ultra-violet që e marrim nga dielli dhe sinjalet e transmetimit për TV dhe radio komunikimet janë të gjitha forma të rrezatimit që janë të zakonshme në jetën tonë të përditshme. Të gjitha këto janë të referuara si rrezatim "jo-jonizues". Rrezatimi i lidhur sidomos me mjekësinë bërthamore dhe përdorimi i energjisë bërthamore, së bashku me rrezet X, është rrezatim 'jonizues', që do të thotë se rrezatimi ka energji të mjaftueshme për të bashkëvepruar me çështjen, sidomos trupin e njeriut, dhe të prodhojë jone, dmth ajo mund të nxjerr një elektron nga një atom.¹¹

Lojet e rrezatimit

Rrezatimi bërthamor lind prej qindra llojeve të ndryshme të atomeve të paqëndrueshme. Përderisa shumë ekzistojnë në natyrë, shumica janë krijuar nga reaksionet bërthamore. Rrezatimi jonizues i cili mund të dëmtojë indet e gjalla është emetuar si atom i paqëndrueshëm (radio nuclide) që ndryshon në mënyrë spontane për t'u bërë atom i llojit të ndryshëm.¹²

Burimet e rrezatimit

Rrezatimi mund të lind nga veprimtaria njerëzore ose nga burimet natyrore. Ekspozimi më i madh i rrezatimit vije nga burimet natyrore. Këto përfshijnë: radioaktivitetin e shkëmbinjve, dheut dhe kores së tokës; radonit, gazit radioaktiv që

¹¹ "Nuclear Medicine". Nuclear Medicine Wikipedia article.

¹² www.mdc.edu/kendall/chmphy/nuclear/types.

del nga shumë shkëmbinj vullkanik dhe mineraleve të uranimit; dhe rrezatimit kozmik. Mjedisi i njeriut ka qenë gjithmonë radioaktiv dhe llogaritet se njerëzit rrezatohen 85% në bazë vjetore nga burime të ndryshme. Rrezatimi që rrjedh nga veprimtaria njerëzore zakonisht llogaritet deri në 15% të ekspozimit të publikut çdo vit. Ky rrezatim nuk është i ndryshëm nga rrezatimi natyror, përveç se ky mund të kontrollohet. Pajisjet me rreze X dhe procedurat tjera mjekësore llogariten si pjesa ku ekspozohet njeriu. Më pak se 1% e ekspozimit është për shkak të pasojave nga testimet e kaluara të armëve bërthamore ose prodhimit të energjisë bërthamore, si dhe termocentraleve me qymyr dhe atyre gjeotermale.¹³ Nevoja për masa mbrojtëse kundër rrezatimit është e dukshme si pasojë e disa rasteve të zbuluara nga autoritetet kufitare. Aftësia për t'u mbrojtur kundër rrezatimit është duke u njohur si një nga çështjet e mëdha të sigurisë me të cilat përballen të gjitha vendet, po ashtu edhe Kosova.

Masat e përgjithshme parandaluese për sigurinë kufitare dhe mbrojtjen e mjedisit në PKK, bazuar në politikën kombëtare

Kosova, bazuar në legjislacionin e saj ka parashikuar masa të përgjithshme dhe të veçanta për sigurinë kufitare dhe mbrojtjen e mjedisit në PKK dhe llojeve tjera të emergjencave ndërkuftare. Në këtë drejtim Kosova ka respektuar traktatet dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në PKK dhe llojet e tjera të emergjencave ndërkuftare. Kuvendi i Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Kosovës, duke ndier nevojën për të sjellë standarde lidhur me sigurinë e kufirit, mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, të cilat janë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian, ka miratuar Ligjet e mëposhtme:

- Ligji për Kontrollin e Kufirit Nr. 04/L-214
- Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03 / L-025.
- Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji Nr. 03/L-104 -Ligj për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare,
- Etj

Po ashtu ka ligje të tjera kombëtare, rregullore dhe udhëzime administrative që merren me çështje të tilla dhe sidomos në Pikat e Kalimit Kufitar. Gatishmëria e qytetarëve dhe autoriteteve komunale dhe rajonale për të bashkëpunuar në gjetjen e zgjidhjeve ndërkuftare, nuk përmban ndonjë qëllim për heqjen e sovranitetit të shtetit. E gjithë kjo ka si për qëllim dëshirën për të shëruar plagët e shkaktuara nga

¹³ <http://www.epa.gov/radiation/sources/>

historia, po ashtu që t'u mundësoj banorëve në të dy anët e kufirit një rast më të mirë për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve dhe zhvillimit ekonomik, kulturor dhe arsimor.

Qëllimi i aktiviteteve në rajonet kufitare dhe bashkëpunimi ndërkufitar është arsye për të hequr pengesat dhe faktorët përçarës që kanë ekzistuar në këto rajone dhe përfundimisht të kapërcej termin "kufi" apo të zvogëlojë rëndësinë e tij me atë deri të një vijë e thjeshtë administrative.

Në rrjedhën e integritimit progresiv evropian dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, social, kulturor dhe mjedisor, banorët e rajoneve kufitare duhet të jetë në gjendje të kërkojnë kushte të krahasueshme për ekzistencë në një Evropë të re, ku vendosmëria për të bashkëpunuar është vënë në praktikë, sepse rëndësia e saj është jetike, politika evropiane mund të tregoj më së miri anën e saj humane: në rajonet kufitare. Aty është vendi ku barrierat duhet të vazhdojnë të bien, në mënyrë që ekzistenca "shpinë-për-shpinë" mund të transformohet në bashkë-ekzistencë.

Masat specifike mbrojtëse në varësi të llojit të rrezikut

Në tërë botën dhe sidomos vendet e BE-së dhe ato jashtë BE-së kanë përpiluar dhe zbatojnë masa të veçanta mbrojtëse dhe parandaluese në varësi të llojit të rreziqeve në lidhje me sigurinë e kufirit (në BE kufijtë e jashtë dhe po ashtu ata nacional), mbrojtjen e mjedisit dhe llojet e tjera të emergjencave ndërkufitare.

Ka ligje të ndryshme, politika dhe procedurat të përpiluara në lidhje me këtë çështje shumë të ndjeshme për sigurinë kombëtare. KE (Komisioni Evropian), ka punuar shumë në plotësimin e këtij boshllëku, ku në shkurt 2009 ka publikuar një komunikatë mbi "Qasja e Komunitetit për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu¹⁴"

Gjatë viteve të fundit, institucionet, autoritetet dhe agjencitë e Kosovës të përfshirë në mbikëqyrjen e kufirit ishin të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e hartimit të dispozitave të përgjithshme, udhëzimeve dhe masave të veçanta, për t'u marrë me lloje të ndryshme të rreziqeve që mund të ndodhin. Autoritetet kompetente shtetërore dhe ato të specializuara duhet të identifikojnë dhe të zbatojnë masat për planifikimin e emergjencës dhe gatishmërisë emergjente në rast të rrezikut nga aksidentet e ndryshme. Këto masa duhet të bazohen në analizën e skenarëve të mundshëm mbi origjinën dhe zhvillimin e aksidenteve të ndryshme dhe për të vlerësuar rrezikun, si p.sh. rrezatimi dhe lloje të tjera të rreziqeve ndaj popullsisë. Plani i emergjencës është një dokument, i cili përcakton masat për ruajtjen e gatishmërisë emergjente, siguron (ofron) mbrojtje, zbut dhe eliminon pasojat e aksidenteve dhe incidenteve të ndryshme.

¹⁴ "A Community approach on the prevention of natural and man-made disasters"

Planet emergjente duhet të hartohen dhe miratohen në nivel kombëtar, rajonal dhe institucional dhe për çdo vend (lokacion ku ndodhë rasti). Si shembull mund të pasqyroj modelin ASUNE (Akti për përdorim të sigurt të Energjisë Bërthamore) që përcakton dy lloje të planeve të emergjencës, sipas qëllimit të tyre:

1. Plani emergjent jashtë vendndodhjes **Off-site** (plan kombëtare) për të mbrojtur popullsinë në rast të aksidenteve të ndryshme me pasoja rrezatimi në tërë vendin;
2. Plani emergjent në vendndodhje për rastin e ndodhur (zhvilluar në koordinim me planin emergjent jashtë vendndodhjes/ off-site).

PËRFUNDIMI

Siç kam deklaruar në fillim, qëllimi im i përgjithshëm ishte shtjellimi i një rës ndër çështjeve më të vështira dhe të ndjeshme të vendit "siguria e Pikave të Kalimit Kufitar (PKK) nga aksidentet dhe incidentet e ndryshme".

Për të hyrë në shekullin e 21 në këtë drejtim apo rrugë, me një "Evropë pa kufij", një kurs i përbashkët i veprimit nga ana e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, OSBE-së, qeverive kombëtare, rajoneve dhe niveleve lokale është po aq i domosdoshëm sa edhe solidariteti ndërmjet rajoneve kufitare dhe ndër-kufitare.

Kjo kartë trajton të gjithë ata partnerë që duan të marrin pjesë në hartimin e këtij procesi të ardhshëm dhe për këtë arsye në veçanti kufiri dhe rajonet ndërkufitare, janë forcë lëvizëse e këtij zhvillimi në përmbushjen e objektivit kryesor sipas konceptit Evropian, që bazohet në tri parime kryesore: kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.

DOKUMENTET REFERUESE

Burimet- Librat

- Robert S. Leiken, *Bearers of Global Jihad? Immigration and National Security after 9/11* (Washington, D.C.: Nixon Center, March 2004).
- Stuart E. Eizenstat, John Edward Porter, Jeremy M. Weinstein, and the Commission on Weak States and U.S. National Security, *On the Brink: Weak States and U.S. National Security* (Washington, D.C.: Center for Global Development, 2004), fq. 57.
- Eric W. "Radiation". (2014) Eric Weisstein's World of Physics.
- Steinman, David and R. Michael Wisner. *Living Healthy in a Toxic World: Simple Steps to Protect You and Your Family from Everyday Chemicals, Poisons, and Pollution*. New York, NY: The Berkley Publishing Group, 1996.

- 'Making the UK safer: detecting and decontaminating chemical and biological agents', The Royal Society, (April 2004)
- Stoto, Michael A et al, 'Syndromic Surveillance: An Effective Tool for Detecting Bioterrorism?', RAND Center for Domestic and International Health Security (February 2004)
- Kosal, Margaret E, 'The Basics of Chemical and Biological Weapons Detectors', Centre for Non-proliferation Studies (November 2003)
- CNN Cold War – Historical Documents: Reagan-Gorbachev transcripts

Të tjera

- <http://www.fas.org/irp/threat/cbw/carus.pdf>
- <http://www.dcaf.ch>
- http://www.who.int/emc/pdfs/Senate_hearing.pdf
- <http://www.emedicine.com/emerg/topic924.htm>
- <http://www.ostp.gov/html/OSTPHomeland.pdf>
- <http://www.interpol.int>
- http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/wp/2014_2015/main/h2020-wp1415-security_en.pdf
- <http://www.iata.org/whatwedo/security/pages/checkpoint-future.aspx>
- http://www.intermin.fi/en/security/border_management
- <http://www.humanitarianinfo.org/iasc/>
- <http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/crisis-preventionand-recovery/undp-in-early-recovery/>
- <http://www.nato.int/eadrcc/>
- http://ec.europa.eu/echo/civil_protection/civil/index.htm
- <http://www.osce.org/what/borders>
- <https://scholar.google.com/scholar?q=lead+and+other+heavy+metals>
- <http://www.globalsecurity.org/military/systems/ground/icam.htm>
- <http://www.cbp.gov/border-security/along-us-borders/border-patrol-sectors/el-paso-sector-texas>

BORDER CROSSING POINT PROTECTION FROM DIFFERENT ACCIDENTS AND INCIDENTS

MSc Samir Krasniqi

Abstract

It is well-known and proven that security is a central problem for every consolidated society and comprehensive policy of that society, where all state mechanisms are involved, regardless of what form of social regulation that society has. Regardless to human/individual safety and security, in the framework of division by types, we could also talk about legal, social security and also world-wide it is known and documented that border security and especially the security of the Border Crossing Point (BCP) from various accidents and incidents, is an important pillar of national security.

During the historical development of society, it is impossible to find instances of the formation and structuring of communities that existed in longer periods of time, which did not need any form of organized protection against the risk and threats that they have been threatened. In this path of building a contemporary, juridical and civic society, community members have aimed and expressed the need for security, respectively the elimination of all forms of risk and threats that could question the existence of that society (physical integrity, general security, individual security, property, etc.) that can occur in different forms, both from outside the borders and from the inside.

Human security focuses on creating an environment where all people feel safe and secure and this contributes to national, regional and international security.

The concept of security, its content and social function can only be understood if this phenomenon is viewed interdisciplinary, for example in security, defense, criminology sciences, etc.

Key words: security, human security, Border Crossing Point, accident, incident.

Article history:

Received: 1.6.2017.

Accepted: 20.7.2017.